

VENDIM
Nr. 27/2020

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 482, DATË 8.5.2020, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 36/2020 ‘PËR PROKURIMET
NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 482, datë 8.5.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.6.2020.